



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 310, datë 25.06.2024

MBI

**TRANSFERIMIN E DY AUTOMJETEVE NË GJYKATËN E POSAÇME TË
SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, i Ministrisë së Financave dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e transferimit të dy automjeteve tip “Hyunday Elantra” viti 2019, me targa AA 045 ZH dhe AA 483 ZH, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri tani në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR